

3 tetor 2022

Fjala e rektorit Bajram Kosumi në hapjen e vitit akademik 2022/23

Të dashur studentë, staf akademik dhe staf administrativ,

Urime për fillimin e vitit të ri akademik!

Duke pasur parasysh rolin e madh të universiteteve në shoqërinë tonë, fillimi i vitit akademik, përkatësisht 1 tetori, është ditë solemne në Kosovë. Të dashur studentë të rinj, mirëserdhët në UKZ!

Duke ju dëshiruar mirëseardhje duhet të ju them se rrugën nuk e keni të shtruar me lule. Do të hasni në vështirësi të shumta, por asnjëherë mos u dëshpëroni e mos u dorëzoni. Do të keni vështirësi për të gjetur një vend pune edhe kur të diplomoni, por as atëherë mos u dorëzoni. Nëse nuk dorëzoheni do ta mbërrini suksesin e synuar.

Kosova është një vend i vogël, jo i pasur, me numër të vogël të qytetarëve, me treg të vogël, i cili e determinon edhe shkallën e ulët të konkurrencës dhe të zhvillimit ekonomik. Kosova ka pasuri të mëdha tokësore e nëntokësore, por ato janë këtu me shekuj, që nga ilirët e deri më sot, por ato nuk na bëjnë e bëjnë vendin të pasur. Të pasur e bëjnë një vend qytetarët, të shkolluar dhe të zotë për punë e ndërmarrësi. Ju mund ta bëni veten, familjen dhe Kosovën të pasur nëse përfitoni maksimumin e dijeve bashkëkohore në fushën tuaj, nëse jeni konkurrentë me kolegët tuaj kudo në botë.

Prandaj mos lejoni ta merrni diplomën pa meritë! Mos lejoni dikë t'ua nënçmojë diplomën! Mos lejoni dikë t'ua nënçmojë universitetin ku e merrni diplomën!

Ju që jeni sot këtu e keni bërë zgjidhjen e duhur. Keni pasur edhe zgjidhje të tjera, por kjo është e duhura. Çdo zgjidhje tjetër do të ishte më e vështirë.

Komuniteti akademik është si një familje e madhe. Mbajeni parasysht këtë: mos u parcializoni por bashkohuni në komunitetin akademik të UKZ. Aty bashkohemi të gjithë: studentët dhe stafi akademik e administrativ. Ky është komuniteti që ju përkrahë juve, studentët e rinj, të zhvilloheni dhe të arrini qëllimet e juaja. Bëhuni pjesë aktive e këtij komuniteti.

Çka do të thotë sukses për juve? Në bazë të suksesit të deritashëm të gjeneratave, diku rreth 30% e juaja që jeni ulur sot në këto karrige nuk do ta marrin diplomën pas tri apo katër viteve. Do të stajnojnë. I lutem secilit prej juve, punoni që të mos jeni ju pjesë e këtij tridhjetë përqindëshi!

UKZ ua jep mundësinë që me pak harxhime t'i vijoni studimet e larta. Si themi ne: e keni universitetin në derë të shtëpisë. Kalojeni kohën sa më shumë këtu, në salla të mësimi e në ushtrime, në bibliotekë, në aktivitete të tjera akademike dhe në aktivitete studentore.

Ju priftë e mbara dhe dalshi faqebardhë!